



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 235, datë 26.11.2018

PËR

**DISA SHTESA E NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 69, DATË 26.05.2011 “PËR
AUTORIZIMIN E INDIVIDËVE PËR SHITJEN E KUOTAVE/AKSIONEVE TË
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE ME OFERTË PUBLIKE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Rregulloren **nr. 69, datë 26.05.2011** “Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 69, datë 26.05.2011 “Për autorizimin e individëve për shitjen e kuotave/aksioneve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive me ofertë publike”, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 3:

i. Titulli i nenit ndryshon si vijon:

“Kërkesat për individët shitës të kuotave/aksioneve”

ii. Shkronja “b” ndryshon si vijon:

“b) të mos kenë qenë dënuar për ndonjë vepër penale dhe të mos kenë çështje penale në proces.”

iii. Në fund të nenit shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Individët e punësuar të një agjenti të shoqërisë administruese, si dhe agjentët-individë, të cilët veprojnë për llogari të shoqërisë administruese sipas një kontrate të veçantë duhet të kenë njohuritë e nevojshme mbi karakteristikat themelore të sipërmarrjes së investimeve kolektive, kuotat/aksionet e të cilës shesin, si dhe njohuri mbi të gjithë rreziqet që lidhen me investimin në sipërmarrjen e investimeve kolektive.”

iv. **Në nenin 5:**

i. Në pikën 2, shprehja “konsiderohet si i miratuar”, zëvendësohet me shprehjen “konsiderohet i vlefshëm vetëm”

ii. Në fund të nenit, pas pikës 3, shtohen pikat 4, 5, 6, 7 me këtë përmbajtje:

“4. Shoqëria administruese dhe individët e punësuar të agjentit apo agjenti-individ duhet të mbajnë dhe përditësojnë rregullisht të dhënat për statusin dhe transaksionet e kryera në lidhje me kuotat/aksionet nëpërmjet individëve të punësuar të agjentit apo agjentit-individ.

5. Shoqëria administruese duhet të sigurojë që individët e punësuar të agjentit apo agjentët-individë grumbullojnë të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për investorët që u ofrohen kuota/aksione të sipërmarrjes së investimeve kolektive, në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi.

6. Shoqëria administruese publikon në faqen zyrtare të saj listën e përditësuar të individëve të punësuar të agjentit, si dhe agjentët-individë, të autorizuar për të shitur kuotat/aksionet e sipërmarrjeve të investimit nën administrimin e saj.

7. Shoqëria administruese është përgjegjëse ndaj investorëve për veprimet ose mosveprimet e individit të punësuar të agjentit apo agjentit-individ për shitjen e aksioneve/kuotave të sipërmarrjes së investimeve kolektive.”

v. **Në nenin 6,** në pikën 5 shtohet një fjali me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti verifikon vlefshmërinë e autorizimit për të shitur aksione/kuota në sipërmarrjet e investimeve kolektive nëpërmjet kërkesës ndaj shoqërisë administruese për dërgimin e dokumentacionit përkatës si dhe nëpërmjet inspektimeve në vend.”

- vi. **Në nenin 7**, kudo ku është fjala “individ”, shtohet shprehja “i punësuar te agjenti dhe agjenti-individ”